



UDHËZON:

1. Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë mënyrën e llogaritjes së të dhënave për kategorizimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM) dhe modelin e deklarimit të kategorisë përkatëse në zbatim të nenit 5 dhe 8, të ligjit nr. 43/2022, “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme”, sipas shtojcave I, II dhe III bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2. Përkufizimet e përdorura në këtë udhëzim kanë të njëjtin kuptim si në ligjin nr. 43/2022 “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme”.

3. AIDA merr masat për zbatimin e mënyrës së llogaritjes së të dhënave dhe modeleve për deklarimin e kategorisë nga ana e NMVM-ve.

4. Për zbatimin e këtij udhëzimi, në shtojcat I, II dhe III bashkëlidhur gjenden modelet për deklarimet e NMVM dhe shembujt për plotësimin e saj dhe janë pjesë integrale e këtij udhëzimi.

5. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

UDHËZIM

Nr. 24, datë 12.7.2022

**PËR MËNYRËN E LLOGARITJES SË TË
DHËNAVE DHE MODELIN E
DEKLARIMIT TË KATEGORISË SË
NDËRMARRJEVE MIKRO, TË VOGLA
DHE TË MESME**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, pikës 8, të nenit 8, të ligjit nr. 43/2022, “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme”,

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Delina Ibrahimaj

**SHTOJCA I - HAPAT E VLERËSIMIT PËR KUALIFIKIM SI NMVM**

Procesi i deklarimit nëse një ndërmarrje është NMVM përbëhet nga **katër hapa**, si vijon:

1. Hapi i parë- Verifikimi nëse ndërmarrja konsiderohet si “ndërmarrje”.

Sipas ligjit, një ndërmarrje është çdo person fizik ose juridik, i regjistruar në regjistrin tregtar, i cili ushtron “veprimtari ekonomike”.

“Veprimtari ekonomike” është faktori përcaktues dhe jo forma ligjore.

“Veprimtari ekonomike” konsiderohet “shitja e produkteve ose shërbimeve me një çmim të caktuar, në një treg të caktuar/të drejtpërdrejtë”.

2. Hapi i dytë- Verifikimi i përmbushjes së dy kriterëve: numri i personelit dhe xhiro vjetore/bilanci total.

Kategoria e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme përbëhet nga ndërmarrje të cilat:

- punësojnë më pak se 250 persona; dhe
- kanë xhiro vjetore ose bilanc vjetor total që nuk e kalon shumën 250 milionë lekë.

Përmbushja e kriterit të numrit të personelit është e detyrueshme për t’u kualifikuar si NMVM. Krahasimi i të dhënave me pragjet për dy kriteret e lartpërmendura përcakton nëse është një ndërmarrje është mikro, e vogël ose e mesme.

- Mikrondërmarrje konsiderohet një ndërmarrje me më pak se 10 persona të punësuar, e cila ka një shifër afarizmi ose bilanc total vjetor jo më të madh se 10 milionë lekë.
- Ndërmarrje e vogël konsiderohet një ndërmarrje me më pak se 50 persona të punësuar, e cila ka një shifër afarizmi ose bilanc total vjetor jo më të madh se 50 milionë lekë.
- Ndërmarrje e mesme konsiderohet një ndërmarrje me 50 persona të punësuar deri në 249 persona të punësuar, e cila ka një shifër afarizmi ose një bilanc total vjetor nga 50 milionë lekë deri në 250 milionë lekë.

Përlllogaritja e kriterit të xhiros vjetore/bilancit vjetor bëhet mbi bazën e pasqyrave financiare vjetore të fundit të miratuara. Ndërmarrjet e reja që nuk kanë miratuar pasqyrat financiare, duhet të bëjnë një deklaratë me mirëbesim (në formën e një “plan biznesi”) gjatë vitit financiar. Ky “plan biznesi” duhet të mbulojë të gjithë periudhën (vitet financiare) derisa ndërmarrja të gjenerojë xhiron.

3. Hapi i tretë- Vlerësimi i të dhënave që duhen përdorur gjatë procesit të vetëdeklarimit.**Kriteri 1: Numri i personelit**

Numri i personelit është një kriter i detyrueshëm për të përcaktuar nëse një ndërmarrje mund të konsiderohet “NMVM” dhe, nëse po, cilës kategori i përket. Nëse një ndërmarrje nuk e plotëson këtë kusht, atëherë nuk mund të konsiderohet NMVM.

Në numrin e personelit përfshihen:

Personeli me kohë të plotë, me kohë të pjesshme, të përkohshme dhe sezonale si vijon:

- a) punëmarrësit;
- b) punëdhënësit;
- c) partnerët që angazhohen në mënyrë të vazhdueshme në aktivitetin e ndërmarrjes dhe që përfitojnë nga përparësitë financiare të saj;



ç) administratorët.

Nuk përfshihen në numrin e personelit:

- a) Punonjësit në kohë prove, dhe
- b) studentët që angazhohen në trajnime profesionale me kontratë.

Matja e numrit të personelit

Numri bazë i punonjësve shprehet në njësi vjetore pune (NjVP). Çdokush që ka punuar me orar të plotë në një ndërmarrje, ose në emër të saj, gjatë gjithë vitit referues, llogaritet si një njësi. Personeli me kohë të pjesshme, punëtorët sezonalë dhe personat që nuk kanë punuar gjatë gjithë vitit llogariten si thyesa të një njësie.

Kriteri 2: Xhiro vjetore

Xhiro vjetore: Xhiro vjetore lidhet me të ardhurat që ka fituar një ndërmarrje gjatë vitit nga shitja e produkteve dhe ofrimi i shërbimeve, pas çdo zbritje. Xhiro nuk duhet të përfshijë tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH) ose taksa të tjera indirekte.

Bilanci total vjetor: Bilanci total vjetor i referohet vlerës së aseteve kryesore të një ndërmarrje.

Çfarë ndodh nëse tejkalohet një prag?

Në Nenin 6, pika 2 parashikohet stabiliteti dhe siguria për ndërmarrjet që janë në pragje të përmbushjes së kriteve për kualifikim si NMVM dhe rrezikojnë t'i tejkalojnë ato për kohësisht gjatë një viti të jashtëzakonshëm dhe/ose në tregje të paqëndrueshme. Nëse një ndërmarrje tejkalon numrin e punonjësve ose kufijtë financiarë gjatë vitit referues, kjo nuk do të ndikojë në gjendjen e saj dhe ndërmarrja do të ruajë statusin e NMVM-së të vitit ushtrimor. Ndërmarrja do të humbasë statusin e NMVM-së nëse tejkalon kufijtë për dy periudha ushtrimore të njëpasnjëshme.

Anasjelltas, një ndërmarrje mund të fitojë statusin e NMVM-së nëse më parë ka qenë një ndërmarrje e madhe dhe më pas kalon nën kufijtë/pragjet në fjalë për dy periudha ushtrimore të njëpasnjëshme.

Numri i vitit	N (NjVP) vjetore	N	N	Statusi
1	NVM	JO NVM	JO NVM	JO NVM
2	NVM	NVM	JO NVM	NVM
3	NVM	NVM	NVM	NVM
4	NVM	JO NVM	NVM	NVM
5	JO NVM	NVM	NVM	NVM
6	JO NVM	JO NVM	NVM	JO NVM
7	JO NVM	NVM	JO NVM	JO NVM
8	JO NVM	JO NVM	JO NVM	JO NVM

(*) Periudha e fundit ushtrimore e miratuar

Qëllimi i Nenit 6, pika 2 e ligjit është të sigurojë që ndërmarrjet që kanë rritje nuk penalizohen me humbjen e statusit të NMVM-së nëse nuk i kalojnë pragjet përkatëse për një periudhë të qëndrueshme. Pika 2, e nenit 6 të ligjit nuk zbatohet në rastin e ndërmarrjeve që tejkalojnë pragjet përkatëse të NMVM-së si rezultat i një ndryshimi të pronësisë pas një bashkimi ose blerje.



Ndërmarrjet që i nënshtrohen një ndryshimi në pronësi duhet të vlerësohen në bazë të strukturës së tyre të aksioneve në kohën e transaksionit dhe jo në kohën e mbylljes së llogarive më të fundit. Si rrjedhim, humbja e statusit të NMVM-së mund të jetë e menjëhershme.

4. Hapi i katërt - Llogaritja e të dhënave:

Për llogaritjen e të dhënave që do të konsiderohen dhe vlerësohen kundrejt pragjeve, një ndërmarrje duhet të përcaktojë nëse është:

- një ndërmarrje **autonome** (kategoria më e zakonshme);
- një ndërmarrje **partnere**; ose
- një ndërmarrje e **lidhur**.

Llogaritjet për secilën kategori të ndërmarrjeve janë të ndryshme dhe përcaktojnë nëse ndërmarrja i plotëson kufijtë e përcaktuar në ligj. Sipas rastit, një ndërmarrje duhet të marrë parasysh:

- vetëm të dhënat e veta;
- një pjesë të të dhënave në rastin e një ndërmarrje partnere; ose
- të gjitha të dhënat e çdo ndërmarrje që konsiderohet e lidhur me të.


Përkufizimi si “ndërmarrje autonome” (Neni 3, pragrafi 7)

Një ndërmarrje është autonome nëse e vetme ose bashkërisht me një ose më shumë ndërmarrje të lidhura, nuk zotëron më shumë se 25% të kapitalit ose të të drejtave të votës së një ndërmarrjeje tjetër, si dhe nuk është e lidhur me një ndërmarrje tjetër në asnjë nga format e parashikuara në pikën 9, të nenit 3.

Një ndërmarrje mund të jetë autonome edhe nëse pragu prej 25% plotësohet ose tejkalohet nga investitorët si vijon, me kusht që këta investitorë të mos jenë të lidhur në kuptim të pikës 9, të nenit 3, individualisht ose bashkërisht me ndërmarrjen në fjalë:

- a) korporatat publike të investimeve, shoqëritë e kapitalit sipërmarrës, individët ose grupet e individëve me aktivitet të rregullt në investimet e kapitalit sipërmarrës, të cilët investojnë kapitalin e vet në ndërmarrje të palistuara, me kusht që investimi total i bizneseve të palistuara në të njëjtën ndërmarrje të jetë më pak se 30 000 000 lekë;
- b) institucionet e arsimit të lartë ose qendrat jofitimprurëse kërkimore;
- c) investitorët institucionalë, përfshirë fondet rajonale të zhvillimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për zhvillimin rajonal dhe kohezionin;
- ç) njësitë e vetëqeverisjes vendore me një buxhet vjetor me më pak se 10 milionë lekë dhe më pak se 5 000 banorë.

Në kuptim të kësaj pike, nuk ekziston asnjë ndikim dominues nëse investitorët e përcaktuar në shkronjat “a”-“ç”, pavarësisht nga të drejtat e tyre si aksionarë, nuk përfshihen direkt ose indirekt në menaxhimin e ndërmarrjes në fjalë.



Të dhënat që duhet të konsiderohen

Nëse ndërmarrje është autonome, përdoret vetëm numrin i punonjësve dhe të dhënat financiare sipas pasqyres së saj financiare vjetore për të vlerësuar nëse i plotëson kriteret e parashikuara në nenin 4 mbi kategoritë e NVMV-ve.

Përfshirjet

Një ndërmarrje mund të jetë autonome nëse ndonjë nga kategoritë e mëposhtme të investitorëve zotëron 25-50 % të kapitalit të saj ose të drejtave të votës.



Korporata publike të investimeve



Institucionet e arsimit të lartë ose qendrat jofitimprurëse kërkimore



Investitori Institucional



Njësitë e vetëqeverisjes vendore




A jam një ndërmarrje partnere? (Neni 3, paragrafi 9)

Kjo marrëdhënie përshkruan situatën e ndërmarrjeve që krijojnë partneritete financiare me ndërmarrjet e tjera, ku asnjë ndërmarrje nuk ushtron kontroll efektiv direkt ose indirekt mbi ndërmarrjen tjetër. Partnerët janë ndërmarrje që nuk janë as autonome dhe as të lidhura me njëra-tjetrën.

Përkufizimi

Një ndërmarrje është ndërmarrje partnere nëse zotëron 25% ose më shumë të kapitalit ose të të drejtave të votës së një ndërmarrjeje tjetër dhe/ose një ndërmarrje tjetër zotëron 25% ose më shumë të kapitalit ose të të drejtave të votës në ndërmarrjen në fjalë dhe ndërmarrja nuk është e lidhur me një ndërmarrje tjetër në kuptim të nenit 3, paragrafi 8 të ligjit.

Ndërmarrje Partnere





Të dhënat që duhet të konsiderohen

Ndërmarrja që po vlerësohet duhet t'i shtojë personelit të saj një proporcion të numrit të personelit dhe të dhënave financiare të partnerit të saj. Ky proporcion do të pasqyrojë përqindjen e aksioneve ose të drejtave të votës, cilado qoftë më e lartë.

Për shembull, nëse një ndërmarrje ka 30 % të aksioneve në një ndërmarrje tjetër, ajo i shton shifrave të saj 30 % të numrit të punonjësve, xhiros/bilancit total të ndërmarrjes partnere. Nëse ka disa ndërmarrje partnere, e njëjta llogaritje duhet të bëhet për secilën ndërmarrje partnere.


Gjithashtu, duhet të konsiderohen të dhënat proporcionale të një ndërmarrje që është e lidhur me një ndërmarrje partnere. Nuk duhet të konsiderohen të dhënat e një partneri të një partneri (shikoni shembujt 2, 6 dhe 7 në aneksin II, të udhëzimit).

Llogaritja e të dhënave të ndërmarrjeve partnere

Ndërmarrja "A" zotëron 33 % të "C" dhe 49 % të "D", ndërsa "B" ka 25 % të aksioneve në ndërmarrjen "A".

Për të llogaritur numrin e personelit dhe të dhënat financiare të "A" duhen shtuar përqindjet e të dhënave për "B", "C" dhe "D" në të dhënat gjithsej.

Totali "A" = 100 % i "A" + 25 % i "B" + 33 % e "C" + 49 % e "D".





A Jam unë një ndërmarrje e lidhur?

Ndërmarrjet e lidhura janë ndërmarrjet që formojnë një grup përmes kontrollit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të shumicës së të drejtave të votës (aksioneve) të një ndërmarrje nga një ndërmarrje tjetër ose përmes aftësisë për të ushtruar një ndikim dominues në një ndërmarrje.


Përkufizimi

“Ndërmarrje të lidhura” janë ndërmarrjet që kanë një nga lidhjet e mëposhtme:

- Një ndërmarrje ka shumicën e të drejtave të votave të aksionarëve ose anëtarëve në një ndërmarrje tjetër;
- një ndërmarrje ka të drejtë të emërojë ose të largojë shumicën e anëtarëve të organeve administrative, menaxhuese ose mbikëqyrëse të një ndërmarrjeje tjetër;
- një ndërmarrje ka të drejtë të ushtrorë një ndikim dominues mbi një ndërmarrje tjetër, në bazë të një kontrate të lidhur me atë ndërmarrje ose të një përcaktimi në memorandum apo nenet e statutit;
- një ndërmarrje, e cila është aksionare ose anëtare e një ndërmarrjeje tjetër, kontrollon e vetme, në përputhje me një marrëveshje me aksionarët e tjerë ose anëtarët e asaj ndërmarrjeje, shumicën e të drejtave të votave të aksionarëve ose anëtarëve në atë ndërmarrje.

Një shembull tipik i një ndërmarrje të lidhur është filiali në pronësi të plotë. Në një marrëdhënie të këtij lloji, përmes pronësisë së një ose më shumë individëve (të cilët veprojnë bashkërisht), konsiderohen ndërmarrjet e lidhura, që veprojnë në tregje të njëjta ose të afërta.

Një ose më shumë persona fizikë që veprojnë bashkërisht





Të dhënat që duhet të konsiderohen

Për ndërmarrjet e lidhura, 100 % e të dhënave të ndërmarrjes së lidhur duhet t'i shtohen të dhënave të ndërmarrjes që vlerësohet për të përcaktuar nëse plotëson kriterin e personelit dhe të xhiros/bilancit.


Si llogariten të dhënat e ndërmarrjeve të lidhura?

Ndërmarrjeve u kërkohet me ligj që të hartojnë pasqyra të konsoliduara ose të përfshihen me anë të konsolidimit të plotë në pasqyrat e një ndërmarrje tjetër. Kur një ndërmarrje nuk krijon pasqyra të konsoliduara dhe ndërmarrja me të cilën është e lidhur (partneri i lidhur) nga ana tjetër ka lidhje me ndërmarrje të tjera, ndërmarrja që po vlerësohet duhet të shtojë 100 % të të dhënave të të gjitha ndërmarrjeve të lidhura dhe përqindjen proporcionale të ndërmarrjeve partnere.

Ndërmarrja "A" zotëron 51 % të "C" dhe 100 % të "D", ndërsa "B" ka 60 % të aksioneve në "A".

Për llogaritjen e numrit të personelit dhe xhiros/bilancit, ndërmarrja "A" merr 100 % të të dhënave nga secila prej katër ndërmarrjeve të tjera, duke qenë se zotërimi i aksioneve/të drejtave në secilin rast është mbi 50 %.

Totall "A" = 100 % i "A" + 100 % i "B" + 100 % i "C" + 100 % e "D"



Pavarësisht nëse një ndërmarrje krijon ose jo pasqyra të konsoliduara, të dhënat që duhen konsideruar janë si vijon:

- të dhënat e çdo ndërmarrje partnere të ndërmarrjes që vlerësohet;
- të dhënat e çdo ndërmarrje të lidhur me ndërmarrjen që vlerësohet;
- të dhënat e çdo ndërmarrje të lidhur me ndonjë nga partnerët e ndërmarrjes në fjalë;
- të dhënat e çdo ndërmarrje të lidhur me ndonjë kompani që është lidhur me ndërmarrjen që vlerësohet;
- të dhënat e çdo partneri për një ndërmarrje të lidhur me ndërmarrjen që vlerësohet.

Marrëdhëniet partner-partner nuk konsiderohen.



SHTOJCA II - SHEMBUJ PRAKTIKË

Shembull 1: “Një lidhje me dy partnerë”


Ndërmarrja “A” është e lidhur me ndërmarrjen “B” përmes zotërimit të 60 % që “B” ka me “A”.

Por “B” gjithashtu ka dy partnerë, ndërmarrjet “C” dhe “D”, të cilat respektivisht zotërojnë 32 % dhe 25 % të “B”.

Llogaritja

Për të llogaritur të dhënat e ndërmarrjes “A”, duhet të shtohet 100 % e të dhënave të “B”, 32 % të të dhënave të “C” dhe 25 % të të dhënave të “D”.

Totali “A” = 100 % i “A” + 100 % i “B” + 32 % i “C” + 25 % i “D”



Shembulli 2: Partneri indirekt dhe ndërmarrja e lidhur

Ndërmarrjet “B” dhe “C” janë të dyja partnere të ndërmarrjes “A”, sepse secila ka aksione prej 38 % në ndërmarrjen “A”. Ndërmarrja “B” është gjithashtu e lidhur me ndërmarrjen “D” me 60 % të aksioneve dhe “C” dhe “E” janë partnerë (40 %).


Llogaritja

Për të llogaritur të dhënat e “A” duhet të shtohen 38 % e të dhënave të grumbulluara të ndërmarrjeve “B” dhe “D” (sepse “B” dhe “D” janë të lidhura), dhe nga ana tjetër, vetëm 38



% të të dhënave të ndërmarrjes “C”. Të dhënat e ndërmarrjes “E” nuk konsiderohen, sepse kjo ndërmarrje partnere nuk është e vendosur direkt me ndërmarrjen “A”

Totali “A” = 100 % i “A” + 38 % i (“B” + “D”) + 38 % i “C”




Shembulli 3 : Grupi i ndërmarrjeve të lidhura

Ndërmarrja “A” ka tre investitorë “B”, “C” dhe “D” dhe secili zotëron 20 % të aksioneve/kapitalit të ndërmarrjes “A”. Këta investitorë janë të lidhur me njëri-tjetrin, duke formuar një grup ndërmarrjesh të lidhura: “B” ka aksione prej 70 % në “C”, dhe “C” ka 60 % aksione në ndërmarrjen “D”.

Llogaritja

Për të llogaritur të dhënat e ndërmarrjes “A”, në një vlerësim të parë ndërmarrja “A” do të ishte autonome, sepse secili investitor zotëron më pak se 25 % të ndërmarrjes “A”. Duke qenë se “B”, “C” dhe “D” janë të lidhura me njëri-tjetrin, si grup ata zotërojnë 60 % të ndërmarrjes “A”. Për këtë arsye, në të dhënat e ndërmarrjes “A” duhet të shtohet 100 % të të dhënave të “B”, “C” dhe “D”.

Totali “A” = 100 % i “A” + 100 % i “B” + 100 % i “C” + 100 % i “D”




Shembulli 4: Partnerë publikë dhe/ose institucionalë që përjashtohen nga llogaritjet
 Ndërmarrja “B”, “C” dhe “D” janë të gjithë partnerë të ndërmarrjes “A” me aksione përkatësisht 25 %, 30 % dhe 25 %. Por ndërkohë “B” dhe “D” janë investitor një universitet dhe një investitor dhe nuk kalojnë 50 % të të drejtave në aksione. Këto ndërmarrje bëjnë pjesë në listën e përjashtimeve, ndaj të dhënat e tyre nuk përfshihen në llogaritje.

Llogaritja

Për të llogaritur të dhënat e “A” duhet të përfshihen 100 % të të dhënave të “A” dhe 30 % të të dhënave të ndërmarrjes “C”:

Totali “A” = 100 % i A + 30 % i “C”





Shembulli 5: Partnerë publikë të lidhur dhe/ose institucional që nuk përjashtohen nga llogaritja


Ndërmarrja “B”, “C” dhe “D” janë të gjithë partnerë të ndërmarrjes “A”, me aksione përkatësisht 25 %, 25 % dhe 30 %. Pavarësisht se “B” dhe “D” janë një universitet dhe korporatë publike e investimit, ato janë të lidhura me njëra -tjetrën dhe mbajtja e tyre e kombinuar e të drejtave të votimit është 55 %, duke tejkaluar pragun 50 % për përjashtimet. Prandaj, të dhënat e tyre duhet të përfshihen në llogaritje.

Llogaritja

Për të llogaritur të dhënat e “A” duhet të përfshihen 100 % të të dhënave të “A”, 25 % të të dhënave të “C” dhe aksionet e përbashkëta të “B” dhe “D” 55 % në aksionet/të drejtat e votës. Duke qenë se “B” dhe “D” së bashku mbajnë 55 % të të drejtave të votimit duhet të mbledhen 100 % të të dhënave të tyre.

Nëse ndërmarrjet e lidhura janë të dyja organe publike ose të lidhura me organe publike, atëherë ndërmarrja “A” nuk do të kategorizohet si NMVM.

Totali “A” = 100 % “A” + 100 % “B” + 25 % “C” + 100 % “D”



Shembulli 6 : Partnerët dhe partnerët e ndërmarrjeve të lidhura


Ndërmarrja “B” është partnere e ndërmarrjes “A” me 25 % të aksioneve. Ndërmarrja “C” është partnere e ndërmarrjes “B”, me 30 % të aksioneve. Gjithashtu, ndërmarrja “A” është e lidhur me ndërmarrjen “D”, me 65 % të aksioneve. Ndërmarrja “E” është gjithashtu partnere e ndërmarrjes “D”, me 25 % të aksioneve. Ndërmarrja “D” ka një ndërmarrje të lidhur, e cila nga ana e saj ka një partner.



Llogaritja

Duhet të konsiderohen të dhënat proporcionale të të gjitha ndërmarrjeve që janë partnerë të ndërmarrjes që do të vlerësohen, si dhe partnerët e çdo ndërmarrje të lidhur. Të dhënat e një partneri të një partneri të ndërmarrjes që vlerësohet, nuk duhet të konsiderohen.

Totali "A" = 100 % e "A" + 25 % e "B" + 100 % e "D" + 25 % e "E" + 100 % e "F" + 25 % e "G"



Shembulli 7 : Një strukturë pronësie komplekse

Ndërmarrja "A" ka ndërmarrje partnere dhe të lidhura, të cilat nga ana e tyre gjithashtu kanë ndërmarrje partnere dhe të lidhura.

Llogaritja


Të dhënat e ndërmarrjeve të lidhura me ndërmarrjen "A" merren parasysh 100 %.

Të dhënat e ndërmarrjeve që janë partnere me ndërmarrjen "A", ose ato që janë partnere në një ndërmarrje që është e lidhur me "A", konsiderohen në mënyrë proporcionale me pronësinë e asaj ndërmarrje partnere.

Të dhënat e ndërmarrjeve të lidhura me ndonjë nga ndërmarrjet e "A" të lidhura ose partnere gjithashtu duhet të konsiderohen.

Të dhënat e një partneri të një ndërmarrje partnere, nuk duhet të konsiderohen.

Totali "A" = 100 % "A" + 100 % "C" + 27 % ("D" + "F") + 25 % ("B" + "E") + 100 % ("H" + "I") + 25 % "J"





SHTOJCA III - FORMATET E DEKLARIMIT

 FORMATI I DEKLARATËS
 INFORMACION PËR KATEGORIZIMIN E NMVM-VE

Identifikimi i ndërmarrjes

Emri i Subjektit

Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS)

Adresa (e zyrës së regjistruar).....

Administratori/ët.....

Kategoria e ndërmarrjes (shikoni shënimin shpjegues)

Zgjidhni për të treguar rastin (rastet) që zbatohet për ndërmarrjen aplikante:

- Ndërmarrje autonome Në këtë rast të dhënat në kutinë e mëposhtme rezultojnë vetëm nga llogaritë e ndërmarrjes aplikante. Plotësoni vetëm deklaratën, jo anekset.
- Ndërmarrje partnere Plotësoni dhe bashkëlidhni aneksin (dhe çdo fletë shtesë), më pas plotësoni deklaratën duke kopjuar rezultatet e llogaritjeve në kutinë e mëposhtme.
- Ndërmarrje e lidhur

Të dhënat e përdorura për të përcaktuar kategorinë e sipërmarrjes

Të llogaritura sipas Nenit 3, të ligjit nr. 43/2022

Periudha e referencës (*)

Numri (NjVP)	Xhiro vjetore (**)	Bilanci total (**)

(*) Të gjitha të dhënat duhet të lidhen me periudhën e fundit të kontabilitetit të miratuar dhe të llogaritur në bazë vjetore. Në rast të "ndërmarrjeve të reja" llogaritë e të cilave nuk janë miratuar, të dhënat që duhet të zbatohen do të mbështeten në bazë të një vlerësimi të besueshëm të kryer gjatë vitit financiar.

(**) mijë lekë

E rëndësishme:

Krahasuar me periudhën e mëparshme të kontabilitetit ka një ndryshim lidhur me të dhënat, që mund të rezultojnë në një ndryshim të kategorisë së ndërmarrjes aplikante (ndërmarrje mikro, e vogël, e mesme ose e madhe).

- Jo
- Po (në këtë rast plotësoni dhe bashkëlidhni deklaratat lidhur me periudhën e mëparshme të kontabilitetit (3).

Nënshkrimi

Emri dhe funksioni i nënshkruesit, i cili autorizohet të përfaqësojë ndërmarrjen:

.....

Unë deklaroj saktësinë e kësaj deklarate dhe të çdo shtojce të saj.

Datë

Nënshkrimi



ANEKSI I DEKLARATËS

LLOGARITJA PËR PARTNERIN OSE NDËRMARRJEN E LIDHUR

Shtojcat që duhet të përfshihen nëse është e nevojshme

- Aneksi A nëse ndërmarrja aplikante ka të paktën një ndërmarrje partnere (dhe çdo fletë shtesë)
- Aneksi B nëse ndërmarrja aplikante ka të paktën një ndërmarrje të lidhur (dhe çdo fletë shtesë)

Llogaritja për partnerin ose llojin e ndërmarrjes së lidhur ⁽¹⁾ (shikoni shënimin shpjegues).

Periodha e referencës ²:

	Numri i personelit	Xhiro vjetore	Bilanci total
1. Të dhënat ⁽²⁾ e ndërmarrjes aplikante ose pasqyrat e konsoliduara (kopjoni të dhëna nga kutia B (1) në aneksin B ⁽³⁾)			
2. Të dhënat e grumbulluara në mënyrë proporcionale (nëse ka) (kopjoni të dhëna nga kutia A në shtojcën A)			
3. Shtoni të dhëna ⁽²⁾ e të gjithë ndërmarrjeve të lidhura (nëse ka) nëse nuk parashikohet me anë të konsolidimit në rreshtin 1 (kopjoni të dhëna nga kutia B (2) në shtojcën B)			
Totali			

(*) mijë lekë

(1) Përkufizimi, Neni 6, paragrafët 2 dhe 3

(2) Të gjitha të dhënat duhet të jenë të lidhura me periudhën e fundit të kontabilitetit të miratuar në bazë vjetore. Në rastin e ndërmarrjeve të reja, llogaritë e të cilave nuk janë miratuar akoma, të dhënat që duhet të aplikohen rrjedhin nga një vlerësim i besueshëm i bërë gjatë vitit financiar (Përkufizimi, Neni 4).

(3) Të dhënat e ndërmarrjes, duke përfshirë numrin e personelit, përcaktohen në bazë të llogarive dhe të dhënave të tjera të ndërmarrjes, ku ekzistojnë, llogaritë e konsoliduara të ndërmarrjes, ose llogaritë e konsoliduara ku ndërmarrja parashikohet nëpërmjet konsolidimit. Të dhënat e futura në rreshtin "Total" në tabelën e mësipërme duhet të futen në kutinë "Të dhënat e përdonura për të përcaktuar kategorinë e ndërmarrjes" në deklaratë.



ANEKSI A

Ndërmarrjet partnere

Për çdo ndërmarrje për të cilën është plotësuar një “fletë e partneritetit” (një fletë për çdo ndërmarrje partnere të ndërmarrjes aplikante dhe për ndërmarrjet partnere të ndonjë ndërmarrje të lidhur, të dhënat e të cilave nuk përfshihen në pasqyrat e konsoliduara të ndërmarrjes së lidhur ⁽¹⁾, të dhënat në “kutinë e partneritetit” duhet të përfshihen në tabelën përmbledhëse të mëposhtme:

Kutia A

Ndërmarrje partnere (emri/identifikimi)	Numri i personelit	Xhiro vjetore	Bilanci total
1.			
2.			
3.			
4.			
5.			
6.			
7.			
Totali			
(*) mijë lekë			

(bashkëlidhni fletët ose zgjeroni tabelën nëse është e nevojshme)

Kujtesë:

Këto të dhëna janë rezultat i një llogaritjeje proporcionale të bërë në “fletën e partneritetit” për çdo ndërmarrje partnere direkte ose indirekte.

Të dhënat që do të rezultojnë në rreshtin “Total” të tabelës së mësipërme duhet të vendosen në rreshtin 2 (për ndërmarrjet partnere) të tabelës në Shtojcën e deklaratës.



FLETA E PARTNERITETIT

1. Identifikimi i ndërmarrjes partnere

Emri i Subjektit

Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS)

Adresa (e zyrës së regjistruar).....

Administratori/ët.....

2. Të dhënat lidhur me ndërmarrjen partnere

Periudha e referencës

	Numri i personelit (AËU)	Xhiro vjetore (*)	Bilanci total (*)
Të dhënat			
(*) 1 000 lekë			

Kujtesë: Këto të dhëna të papërpunuara rrjedhin nga llogaritë dhe të dhënat e tjera të ndërmarrjes partnere, të konsoliduara nëse ato ekzistojnë. Atyre u shtohet 100% të të dhënave të ndërmarrjeve që janë të lidhura me këtë ndërmarrje partnere, përveç kur të dhënat e llogarive të atyre ndërmarrjeve të lidhura janë të përfshira nëpërmjet konsolidimit në llogaritë e ndërmarrjes partnere (3). Nëse është e domosdoshme, shtoni “fletë të lidhjes” për ndërmarrjet që nuk përfshihen nëpërmjet konsolidimit.

3. Llogaritja proporcionale

a) Tregoni saktë aksionet ⁽⁴⁾ e ndërmarrjes (ose e ndërmarrjes së lidhur nëpërmjet të cilës marrëdhënia me ndërmarrjen partnere është krijuar) gjithashtu edhe në ndërmarrjen partnere për të cilën lidhet kjo fletë:

Tregoni gjithashtu zotërimin e ndërmarrjes partnere me të cilën lidhet kjo fletë në krijimin e deklaratës nga ndërmarrja (ose në ndërmarrjen e lidhur):

b) Niveli më i lartë i këtyre përqindjeve të zotërimit duhet të zbatohen për të dhënat e papërpunuara të futur në kutinë e mëparshme. Rezultatet e kësaj llogaritjeje proporcionale duhet të jepen në tabelën e mëposhtme:

“Kutia e Partneritetit”

Përqindjet	Numri i personelit	Xhiro vjetore	Bilanci total
Rezultatet proporcionale			
(*) mijë lekë			

Këto të dhëna duhet të futen në kutinë A në Aneksin A



ANEKSI B
Ndërmarrjet e lidhura

A) PËRCAKTONI RASTIN QË ZBATOHET PËR NDËRMARRJEN APLIKANTE

Rasti 1: Ndërmarrja aplikante krijon llogaritë e konsolidura ose parashikohet me anë të konsolidimit në llogaritë e konsoliduara të ndërmarrjes tjetër (Kutia B (1))

Rasti 2: Ndërmarrja aplikante ose një ose më shumë ndërmarrje të lidhura nuk krijojnë llogari të konsoliduara ose nuk përfshihen në llogaritë e konsoliduara (Kutia B (2)).

Shënime: Të dhënat e ndërmarrjes, të cilat lidhen me ndërmarrjen e aplikantit, rrjedhin nga llogaritë e tyre dhe të dhënat e tjera të tyre, të konsoliduara nëse ato ekzistojnë. Atyre i llogariten në mënyrë proporcionale të dhënat e çdo ndërmarrje të mundshme partnere të asaj ndërmarrje të lidhur, që ndodhen menjëherë në rrjedhën e sipërme ose rrjedhën e poshtme nga ajo, përveçse kur është përfshirë nëpërmjet konsolidimit (1).

B. METODAT E LLOGARITJES PËR ÇDO RAST:

Në rastin 1: Llogaritë e konsoliduara shërbejnë si bazë për llogaritjen. Plotësoni Kutinë B (1) më poshtë.

Kutia B (1)

	Numri i personelit	Xhiro vjetore	Bilanci total
Totali			

(*)Kur në llogaritë e konsoliduara nuk shfaqen të dhëna për numrin e personelit, llogaritja kryhet duke shtuar të dhënat nga ndërmarrjet, me të cilën lidhet ndërmarrja në fjalë.

(**) 1 mijë Euro.

Të dhënat e rreshtit "Total" të tabelës së mësipërme përfshihen në rreshtin 1 të tabelës në Aneksin e deklaratës.

Identifikimi i ndërmarrjeve të përfshira nëpërmjet konsolidimit

Ndërmarrja e lidhur (emri/identifikimi)	Adresa (e zyrës së regjistruar)	Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS)	Administratori/ët
A.			
B.			
C.			
D.			
E.			

E rëndësishme: Ndërmarrjet partnere të një ndërmarrje të tillë të lidhur, që nuk janë të përfshira akoma nëpërmjet konsolidimit, trajtohen si partnerë të drejtpërdrejtë të ndërmarrjes aplikante. Të dhënat e tyre dhe një "fletë partneriteti" duhet të shtohet në Aneksin A.

Në rastin 2: Për çdo ndërmarrje të lidhur (duke përfshirë lidhjet nëpërmjet ndërmarrjeve të tjera të lidhura) plotësoni një "fletë të lidhjes" dhe thjesht shtoni llogaritë e të gjitha ndërmarrjeve të lidhura duke plotësuar Kutinë B (2) më poshtë.



Kutia B (2)

Ndërmarrja Nr.	Numri i personelit	Xhiro vjetore (mijë lekë)	Bilanci total (mijë lekë)
1. (*)			
2. (*)			
3. (*)			
4. (*)			
5. (*)			
Totali			

(*) bashkëlidhni një "fletë lidhjeje" për çdo ndërmarrje

Të dhënat e futura në rreshtin "Total" të tabelës së mësipërme duhet të futen në rreshtin 3 (lidhur me ndërmarrjet e lidhura) të tabelës në Aneksin e deklaratës.

FLETA E LIDHJES

(vetëm për ndërmarrjet e lidhura që nuk përfshihen me anë të konsolidimit në Kutinë B)

1. Identifikimi i ndërmarrjes

Emri i Subjektit

Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS)

Adresa (e zyrës së regjistruar).....

Administratori/ët.....

2. Të dhënat mbi ndërmarrjen

Periudha e referencës

	Numri i personelit	Xhiro vjetore	Bilanci total
Totali			
(*) mijë lekë			

Këto të dhëna duhet të futen në Kutinë B (2) në Aneksin B.

E rëndësishme: Të dhënat e ndërmarrjeve, të cilat lidhen me ndërmarrjen aplikante, rrjedhin nga të dhënat e tyre dhe të dhënat e tyre të tjera, të konsoliduara nëse ekzistojnë. Atyre u shtohen në mënyrë proporcionale të dhënat e ndonjë ndërmarrje të mundshme partnere të asaj ndërmarrja të lidhur, që ndodhet menjëherë në rrjedhën e sipërme ose të poshtme, në rast se nuk është e përfshirë nëpërmjet konsolidimit ⁽³⁾.

Këto ndërmarrje partnere trajtohen si ndërmarrje partnere direkte të ndërmarrjes aplikante. Të dhënat e tyre dhe "fleta e partneritetit" duhet të shtihet në Aneksin A.

